



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:138693
Datë: 14.02.2025
Numri i dokumentit: 06850151

CAP.nr.1895/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË- me gjyqtarin individual Fatmir Baloku, në çështjen juridiko-civile përmbare të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, kundër debitorit E. (H.) D. nga fshati, komuna e Vushtrrisë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.43/24, të datës 30.07.2024, me datë 06.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e themeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.43/24, i datës 30.07.2024 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, CPP.nr.43/24, të datës 30.07.2024, ka vendosur si vijon: I. PRANOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit E. (H.) D., SHFUQIZOHET PJESËRISHT urdhri për lejimin e përmbaremit, P.nr.708/24, i datës 23.04.2024 dhe OBLIGOHET debitori E. (H.) D., që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KESco) në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike për periudhën 01.01.2023 deri me 07.05.2024 t'ia paguaj shumën prej 282.76 Euro, me kamatë ligjore, vjetore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbaremit 23.04.2024, deri në pagesën definitive të borxhit. II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit në shumë prej 1,179.00 Euro për periudhën prej 21.05.2018 deri më 31.12.2022 si e PABAZUAR.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbaremit, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e kreditorit të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbaremit apo aktvendimi i atakuar të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, me propozim që ankesa e kreditorit të refuzohet si e pabazë.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, e në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli në Prishtinë, me datë 23.04.2024, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga kreditori.

Përmbartuesi Privat me urdhrin për përmbartim P.nr.708/24, të datës 23.04.2024, e ka lejuar propozimin për përmbartim.

Kundër urdhrin për përmbartim debitori me datën 02.05.2024 ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 13.05.2024, ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me aktvendimin e atakuar CPP.nr.43/24, të datës 30.07.2024, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për çka u deshtë që ky aktvendim të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Gjykata e Apelit vlerëson se kreditori duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga i njëjti, me datën 23.04.2024 ka ushtruar propozimi për përmbartim ndaj debitorit, duke e ngarkuar debitorin me borxhin në shumën prej 2,386.75 euro, për periudhën kohore nga data 21.05.2018 deri me datën 04.05.2024, ndërsa gjykata e shkallës së parë në pikën I të dispozitivit të aktvendimit të atakuar e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit dhe ka obliguar debitorin që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 282.76 euro për periudhën nga data 01.01.2023 deri me datë 07.05.2024, ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të atakuar e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesës së kreditorit në shumën prej 1,179.00 euro për periudhën nga data 21.05.2018 deri me datën 31.12.2022, çka nënkupton që gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar nuk ka vendosur saktë për shumën e borxhit të kërkuar nga kreditori sipas propozimit për përmbartim, e që sipas këtij propozimi rrjedh se borxhi i kërkuar nga kreditori për periudhën nga data 21.05.2018 deri me datën 04.05.2024 është në shumën prej 2,386.75 euro dhe jo në shumën prej 1,461.76 euro siç e ka përcaktuar gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, nga çka rezulton se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktvendimit.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që për t'i evituar dhe sqaruar të gjitha paqartësitë lidhur me borxhin e kërkuar nga kreditori, të sqarohet saktë se cili është borxhi i debitorit për periudhën kohore si në propozimin për përmbartim, ku pas kësaj gjykata të ketë mundësi që të vlerësoj drejtë kundërshtimin e debitorit sipas prapësimit të ushtruar, apo dhe

deklarimet e tjera të tij eventuale të cilat mund t'i parashtroj, ashtu që në dispozitiv të aktvendimit duhet të ceket saktë pjesa aprovuese apo pjesa refuzuese e kërkesës, e cila në dispozitiv të aktvendimit duhet të përputhet më shumë totale të borxhit të kërkuar nga kreditori si në propozimin për përmbarrim, e apo ashtu dispozitivi duhet të jetë në harmoni me arsyetimin, ashtu që duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se *"Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1895/24, me datë 06.02.2025

Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v